



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit

Datë 22.12.2025

**RAPORT VENDIMMARRJEJE**

**Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E LISTES EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026.**

**Baza ligjore:**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenit 28, pika 4 shkronjat a, b dhe d, të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 32, pika 2, të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 2, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbërit" të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr.8626, datë 22.06.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" të ndryshuar, nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 666, datë 10.10. 2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në Institucionet Arsimore Parauniversitare Publike" i ndryshuar, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.389, datë 03.11.2025 "Për ngritjen e komisionit përfitimin e kërkeshave përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026".

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Cfarë propozohet në projektvendim):**

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga komisioni përfitimin e kërkeshave përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore

publike për vitin shkollor 2025-2026", i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e listës emërore të nxënësve të Shkollave 9-vjeçare që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës, për vitin shkollor 2025-2026, sipas tabelës nr.1, Lista emërore e nxënësve të Shkollave 9-vjeçare me nr. rendor nga 1-631, bashkalidhur.
2. Miratimin e listës emërore të nxënësve të Shkollave të Mesme të Përgjithshme të Bashkisë Durrës, Shkollës së Orientuar Sportive "Benardina Qerraxhia" si dhe konviktit të kësaj shkolle, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2025-2026, sipas tabelës nr.2, Lista emërore të nxënësve të Shkollave të Mesme dhe konviktit te shkollës "B.Qerraxhi" me nr. rendor nga 1-170, bashkalidhur.
3. Miratimin e listës emërore të nxënësve të vitit të parë që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2025-2026, të Shkollës së Mesme Teknologjike "Hysen Çela", të Shkollës së Mesme Profesionale "Beqir Çela", të Shkollës së Mesme Profesionale Kombëtare "Charles Telford Ericson", Golem Kavajë sipas tabelës nr.3, Lista emërore e nxënësve të vitit te parë që propozohen si përfitues burse në Shkollën e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Shkollën e Mesme Profesionale "Beqir Çela", dhe në Shkollën e Mesme Profesionale Kombëtare "Charles Telford Ericson", Golem Kavajë me nr.rendor nga 1-58, bashkalidhur.
4. Miratimi listës emërore e nxënësve të vitit te dyta e lart, që vazhdojnë bursën, të Shkollës së Mesme Teknologjike "Hysen Çela" dhe Shkollës së Mesme Profesionale "Beqir Çela" për vitin shkollor 2025-2026 sipas tabelës nr. 4, Lista emërore e nxënësve të vitit të dytë e lart, që vazhdojnë bursën në Shkollën e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Shkollën e Mesme Profesionale "Beqir Çela" me nr. rendor nga 1-267, bashkalidhur.
5. Miratimin e numrit të nxënësve dhe mësuesve për shkollën speciale PLM, ku numri i nxënësve dhe fëmijëve të regjistruar është 110 dhe i mësuesve përfitues është 30, për vitin shkollor 2025-2026.
6. Ngarkohen Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporte e Komunitete Fetare, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

#### **Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Fonde nga qeveria qendrore dhe nga buxheti i bashkisë Durrës.

#### **Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026.

### **Impakti social/grupet që preken:**

## Nxenësit përfitues sipas listave bashkëlidhur

### A ēshtē objekt konsultimi: (PO/JO)

-10-

**Komisioni i përherëshëm/përkohshëm i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, u mblodhë më datë 22.12.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 9 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shqëruar të tij.**

## Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përherëshëm/përkohshëm:

Georgijev's hapsi subcollyci e konusbut  
pi spichit te sendit te dites. Pich  
te prav'stuit pi pychje nose iu aps  
ol'stutu. Te prav'stuit rane shalor +  
pi sialium. pi slyutu. te meyekalit.  
te ntsleccyit e te loslillit bashkale

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

## T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:



- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e-

## **Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit**

I Kryetar

Denisa Luarasi

John

2 Zv/Kryetar Blerina Reçi  
3 Sekretar Ilir Paja ~~Zv~~ / Ecimbeta Matog   
4 Anëtar Nurije Gjoni  
5 Anëtar Ermal Braholli  PRO